VENDIM
Nr.3, datë 6.2.2008

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Vladimir Kristo	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Gjergj Sauli	anëtar i	"	"
Fehmi Abdiu	anëtar i	"	"
Kristofor Peçi	anëtar i	"	"
Kujtim Puto	anëtar i	"	"
Petrit Plloçi	anëtar i	"	"
Sokol Sadushi	anëtar i	"	"
Sokol Berberi	anëtar i "	"	
Xhezair Zaganjori	anëtar i	"	"

me sekretare Brunilda Bara, në datë 5.11.2007, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen me nr.49/5 Akti, që i përket:

KËRKUES: GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR BULQIZË
SUBJEKTE TË INTERESUARA:
1. KUVENDI I SHQIPËRISË, përfaqësuar nga z.Lulzim Lelçaj, me autorizim.
2. KËSHILLI I MINISTRAVE, përfaqësuar nga z.Enkelejd Alibeaj, me autorizim.
3. PROKURORIA E PËRGJITHSHME, në mungesë.
OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë ka paraqitur para Gjykatës Kushtetuese një kërkesë me anë të së cilës pretendon se neni 59/1 i Kodit të Procedurës Penale, i cili parashikon të drejtën e të dëmtuarit akuzues për të paraqitur kërkesë para gjykatës, me qëllim vërtetimin e akuzës dhe kërkimin e shpërblimit të dëmit, është në kundërshtim me nenin 148/1 të Kushtetutës. Për këtë arsye, ajo ka kërkuar para Gjykatës Kushtetuese shqyrtimin e kushtetutshmërisë së dispozitës së nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale.

Argumenti kryesor i parashtruar në vendimin e kësaj gjykate ka të bëjë me faktin se kjo dispozitë bie ndesh me nenin 148/1 të Kushtetutës, pasi kompetencën për të filluar ndjekjen penale dhe për pasojë hapjen e hetimit gjyqësor e ka vetëm prokuroria. Sipas kërkuesit, dispozita e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale e kalon të drejtën për të filluar ndjekje penale nga prokurori tek i dëmtuari akuzues, duke kapërcyer parashikimin kushtetues për këtë qëllim. Për këtë arsye, gjykata ka argumentuar në vendimin e pezullimit se dispozita e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale është antikushtetuese dhe duhet të shfuqizohet.

Përfaqësuesi i subjektit të interesuar, Kuvendit të Shqipërisë, është shprehur se pretendimet e kërkuesit janë të pabazuara, duke parashtruar se:

- Kërkuesi nuk legjitimohet pasi nuk arrin të argumentojë antikushtetutshmërinë e objektit të kërkesës në vendimin gjyqësor;

- Pretendimi i kërkuesit nuk është i bazuar, pasi neni 148/1 i Kushtetutës i jep atributin e ndjekjes penale jo vetëm prokurorit, por edhe palës së dëmtuar, e cila merr pjesë aktive në proces;

- Kërkesa e gjykatës vjen në kundërshtim me praktikën e Gjykatës Kushtetuese, konkretisht me vendimin nr.39, datë 23.6.2000 të saj, ku theksohet, se kërkesën për marrjen e autorizimit për ndjekje penale të personave që gëzojnë imunitet mund ta bëjë vetë gjykata pranë së cilës është depozituar kërkesa e të dëmtuarit akuzues dhe për këtë, ajo i drejtohet Kuvendit të Republikës së Shqipërisë. Pra, sipas tij, vetë Gjykata Kushtetuese ka pranuar vënien në lëvizje të gjykatës së zakonshme për rastet e parashikuara nga neni 59/1 i Kodit të Procedurës Penale.

Përfaqësuesi i Këshillit të Ministrave kundërshtoi pretendimet e kërkuesit me këto argumente:

Dispozita e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale nuk i heq të drejtën prokurorisë të nisë procedimin penal ndaj autorit të veprës penale, ajo thjesht i krijon mundësinë të dëmtuarit akuzues të nisë procedimin. Kushtetuta i ka njohur si rregull prokurorisë fillimin e procedimit penal, por në rastet kur i dëmtuari ka prova dhe fakte të mjaftueshme, mund të hapë çështje penale për vepra që nuk kanë

rrezikshmëri shoqërore të madhe dhe për të cilat prokuroria nuk është e mendimit se duhet filluar hetimi.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes, Xhezair Zaganjori, përfaqësuesit e subjekteve të interesuara dhe shqyrtoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë ka nisur shqyrtimin e çështjes penale ndaj të akuzuarit Sh.L. për veprën penale "dëmtime të tjera me dashje", parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal. Kjo çështje i është paraqitur asaj nga e dëmtuara akuzuese L.L. dhe mbi këtë bazë, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë ka nisur shqyrtimin e saj. Bazuar në nenin 145/2 të Kushtetutës, kjo gjykatë ka iniciuar një kontroll incidental para Gjykatës Kushtetuese me argumentin se neni 59/1, të cilit ajo duhet t'i referohet për zgjidhjen e çështjes konkrete, bie ndesh me nenin 148/1 të Kushtetutës.

Gjykata Kushtetuese çmon se duke iu referuar nenit 145/2 të Kushtetutës dhe nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese", Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë legjitimohet në paraqitjen e kërkesës së saj. Nga materialet e dosjes gjyqësore rezulton se kjo gjykatë është vënë në lëvizje nga i dëmtuari akuzues, i cili pretendon se ndaj tij është kryer një vepër penale. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Bulqizë është e detyruar t'i referohet nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale. Nisur nga këto rrethana, Gjykata Kushtetuese vlerëson, se çështja që ka për gjykim gjykata e rrethit, ka lidhje të drejtpërdrejtë me dispozitën e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale, që kërkohet të shfuqizohet si antikushtetuese.

Sa i përket objektit të kërkesës së paraqitur, Gjykata Kushtetuese e konsideron të nevojshme të ndalet fillimisht në kuptimin e nenit 148/1 të Kushtetutës, i cili përcakton rolin dhe funksionin e organit të prokurorisë në Republikën e Shqipërisë.

Neni 148/1 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon: "Prokuroria ushtron ndjekjen penale, si dhe përfaqëson akuzën në gjyq në emër të shtetit". Nga përmbajtja e kësaj dispozite rrjedh se ndjekja penale është detyrë ekskluzive e shtetit. Një nga funksionet kryesore të shtetit të së drejtës është respektimi i kuadrit normativ nëpërmjet sigurimit të një drejtësie penale funksionale. Përcaktimi sa më i saktë i detyrave që ka secili aktor në procesin penal është një nga kërkesat kryesore që duhet të plotësojë kuadri kushtetues dhe ligjor në një shtet të së drejtës. Ndjekja penale që zhvillohet mbi bazën e akuzës publike duhet të jetë e mbështetur në dispozita ligjore të përcaktuara saktë, me qëllim dhënien nga gjykata të një vendimi të drejtë, brenda një afati të arsyeshëm, duke garantuar mbrojtjen e individit nga arbitrariteti dhe shpërdorimi i pushtetit shtetëror. Ky detyrim i shtetit rrjedh nga fakti se ai është garanti i të drejtave dhe lirive themelore të individit dhe si i tillë duhet të parashikojë të gjithë mekanizmat e nevojshëm dhe procedurat konkrete për funksionimin e tyre, me qëllim dhënien e drejtësisë sipas kritereve të përcaktuara qartë dhe në mënyrë sa më të detajuar[*].

Për këtë qëllim, ligjvënësi ka parashikuar ngritjen e një organi të posaçëm për ushtrimin e ndjekjes penale në shërbim të mbrojtjes së interesave të shtetit dhe të shoqërisë. Organi i prokurorisë është një nga mekanizmat e domosdoshëm që ndihmon në dhënien e drejtësisë penale. Ky organ i specializuar ka si funksion kryesor ushtrimin e ndjekjes penale në emër të shtetit dhe përfaqësimin e akuzës publike në gjyq. Ligji procedural penal parashikon të gjitha fazat e hetimit paraprak që duhet të kryhen nga prokuroria, me qëllim vënien para përgjegjësisë të personave që dyshohen si autorë të veprave penale.

Me qëllim që prokurori të arrijë të ngrejë akuzë kundër këtyre subjekteve, ai duhet të mbledhë fakte dhe prova me anë të të cilave, në tërësinë e tyre, të mund të arrijë të provojë para gjykatës fajësinë e personit që akuzohet. Nisur nga parimi i ligjshmërisë, prokuroria është e detyruar të hetojë me hollësi dhe të mbledhë prova, nëse ka, kundër çdo të dyshuari. Akuza është procedimi penal i një personi, ndaj të cilit bien dyshime si autor i kryerjes së një vepre penale, të parashikuar si të tillë nga legjislacioni penal[†]. Ngritja e akuzës publike nga prokurori konsiderohet si hapi i parë i ndjekjes penale të personit të dyshuar.

Sipas fjalorit të gjuhës së sotme shqipe, me ndjekje penale duhet të kuptohet veprimi juridik që ndërmerret kundër dikujt që ka shkelur ligjin[‡]. Pra, ndjekja penale nënkupton kryerjen e të gjitha veprimeve procedurale të parashikuara nga ligji me qëllim vërtetimin e akuzës së ngritur nga prokurori. Procedimi i

[*] Peter Badura, Staatsrecht (1996) fq. 597.

[†] Barron's Law Dictionary, Fifth Edition, fq. 8.

[‡] Fjalori i Gjuhës së Sotme Shqipe (2002), fq. 838.

personit të akuzuar për kryerjen e një vepre penale nga organi i ngarkuar me këtë funksion përfshin hetimin e plotë nga organi i akuzës, mbi bazën e të cilit gjykata do të vendosë fajësinë ose pafajësinë e të dyshuarit për kryerjen e veprës penale[*]. Elemente të këtij procesi janë: caktimi i masave të sigurimit, njoftimi i akuzës dhe pyetja e të pandehurit, kqyrja dhe kontrolli i personit ose i banesës, sekuestrime, marrja në pyetje e dëshmitarëve dhe mbledhja e provave të tjera[†]. Të gjitha këto hapa kryhen nën drejtimin dhe përgjegjësinë ekskluzive të prokurorit, i cili që në momentin që vihet në dijeni të veprës penale, kryen çdo veprim hetimor që e çmon të nevojshëm për identifikimin e autorit të kësaj vepre dhe marrjen e tij në përgjegjësi penale.

Sipas nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale, prokuroria nuk është e detyruar të fillojë ndjekjen penale, ose nëse e ka filluar duhet ta pushojë atë, kur nuk arrin të provojë se ndodhet vërtet para një vepre penale apo një të dyshuari si autor. Veprimi i kundërt do të binte ndesh me parimin e ligjshmërisë së veprimtarisë së prokurorisë, parashikuar nga neni 148/3 i Kushtetutës si dhe nga neni 24/2 i Kodit të Procedurës Penale.

I tërë ky proces njihet edhe si hetim paraprak që kryen prokuroria për të vërtetuar akuzën e ngritur kundër një personi të akuzuar për kryerjen e një vepre penale. Hetimi në kuptim të ligjit procedural penal nënkupton tërësinë e veprimeve të kryera nga organi i specializuar për këtë qëllim, pra nga prokuroria dhe policia gjyqësore, me qëllim mbrojtjen e akuzës publike në procesin gjyqësor[‡]. Mbi këtë bazë, prokurorisë i lind ligjërisht detyrimi të ngrejë akuzën para gjykatës kompetente. Hetimi paraprak pasohet nga hetimi gjyqësor, i cili nxjerr vendimin e fajësisë ose pafajësisë së të pandehurit.

Nëse prokuroria arrin në përfundimin se ndodhet para provave dhe fakteve të mjaftueshme, fillon ndjekjen penale ndaj personit të dyshuar si autor i veprës. Në raste të tilla, prokurori i çështjes, në bazë të nenit 148 të Kushtetutës dhe dispozitave konkrete procedurale dhe materiale penale, ka detyrë të përfaqësojë dhe të mbrojë akuzën duke kërkuar nga gjykata, mbi bazën e provave dhe të fakteve të mbledhura, sipas rastit, dënimin e autorit të veprës penale. Këtu qëndron edhe veçoria e prokurorisë, pasi asnjë organ tjetër nuk është i autorizuar të fillojë ndjekjen penale dhe të përfaqësojë akuzën në gjyq përveç asaj. Pra, procedimi penal dhe ngritja e akuzës publike është tagër e prokurorisë. I takon këtij organi, në bazë të nenit 148/1 të Kushtetutës dhe nenit 24/3 të Kodit të Procedurës Penale, të ushtrojë ndjekje penale dhe të ngrejë akuzë publike në emër të shtetit, nëse ndodhet para kryerjes së një vepre penale të parashikuar si të tillë nga Kodi Penal.

Në ndryshim nga sa më lart, kur ndodhemi para veprave penale për të cilat parashikohet shprehimisht ndërhyrja e të dëmtuarit akuzues, është vetëm ky person që mund të ngrejë akuzë private ndaj autorit të veprës penale. Në dispozita konkrete të Kodit të Procedurës Penale, duke përfshirë edhe nenin 59/1 dhe nenin 284, janë parashikuar të drejtat dhe detyrimet e çdo subjekti në procesin penal, duke rregulluar edhe rastet në të cilat ndërhyrja e prokurorit në hetim ose gjykim nuk është e domosdoshme. Këto raste janë të pakta dhe duhet të karakterizohen nga mungesa e rrezikshmërisë së lartë shoqërore dhe interesi i vogël publik në çështjen konkrete. Janë pikërisht këto vepra që parashikohen në nenin 59/1 dhe 284 të Kodit të Procedurës Penale.

Thelbi i akuzës private është vënia para përgjegjësisë e autorit të një vepre nga e cila të dëmtuarit, sipas vlerësimit të tij subjektiv, i kanë ardhur pasoja negative. Kusht i domosdoshëm për të ngritur këtë akuzë është që i dëmtuari të jetë viktimë e njërës prej atyre veprave të parashikuara për këtë qëllim nga ligji procedural penal. Vepra të tilla konsiderohen me rrezikshmëri jo të madhe shoqërore dhe që nuk cenojnë rendin publik, si p.sh. dëmtime të tjera me dashje (neni 90), fyerja (neni 119), hyrja në banesë pa pëlqimin e tjetrit (neni 112/1) etj. të parashikuara nga Kodi Penal. Në hartimin e këtij parashikimi, ligjvënësi, ka pasur parasysh se nuk është në interesin publik ushtrimi i ndjekjes penale dhe, sipas rastit, dënimi i autorit të një vepre me pasoja të vogla ose të një mase të tillë që nuk rrezikojnë shëndetin, pasurinë apo jetën e të dëmtuarit. Ligjvënësi është përpjekur të vendosë një balancë sa më të drejtë midis interesave publikë, nga njëra anë, të përfaqësuara dhe të mbrojtura nga prokuroria dhe interesave privatë nga ana tjetër, që lidhen ngushtë me individin dhe që për këtë arsye mund të mbrohen drejtpërdrejt prej tij.

Gjykata Kushtetuese thekson se, në rastet e parashikuara nga neni 59/1, nuk përjashtohet tërësisht pjesëmarrja e prokurorit. Ai ka të drejtë, që gjatë gjykimit të këtyre çështjeve të marrë pjesë duke kërkuar, sipas rastit, fajësinë ose jo të të pandehurit. Përjashtimi i hetimit paraprak nga këto çështje dhe lejimi i të dëmtuarit akuzues për të ngritur akuzë nuk është marrje e kompetencave të prokurorit, por thjesht dhënie e

[*] Black's Law Dictionary, Seventh Edition, fq. 1221.

[†] Kreu i VII i Kodit të Procedurës Penale të RSh.

[‡] Black's Law Dictionary, Seventh Edition, fq. 830.

mundësisë të dëmtuarit për të qenë aktiv në një proces ku ai është i interesuar drejtpërdrejt[*].

Ashtu siç është theksuar dhe në jurisprudencën e mëparshme të saj, Gjykata Kushtetuese çmon se pozita procedurale e prokurorit është e një lloji të veçantë. Ai nuk është palë në debatin gjyqësor që zhvillohet midis të pandehurit dhe të dëmtuarit akuzues. Për këtë kategori veprash penale ai është i përjashtuar me ligj nga roli i tij si përfaqësues i akuzës dhe si autoritet që ushtron ndjekjen penale[†].

Instituti i të dëmtuarit akuzues, si subjekt që mund të iniciojë procesin penal, njihet prej kohësh nga legjislacionet e vendeve të tjera. Në legjislacionin tonë procedural ky institut ka qenë parashikuar edhe në Kodet e Procedurës Penale të viteve 1953 dhe 1979. Si i tillë, me ndryshimet e bëra në vitin 2002, ai parashikohet edhe në Kodin aktual të Procedurës Penale[‡].

Ngritja e akuzës nga i dëmtuari, e njohur ndryshe si akuzë private, nuk varet nga vendimmarrja e prokurorisë. I dëmtuari i drejtohet direkt gjykatës me akuzën e tij dhe merr pjesë aktivisht në proces për ta bindur gjykatën me anë të provave dhe fakteve që të marrë një vendim në favor të tij. I dëmtuari akuzues ka të drejtë të shfrytëzojë të gjitha mjetet juridike të njohura nga legjislacioni procedural, përfshirë këtu edhe të drejtën e ankimit apo rekursin.

Në rastet kur gjykata duhet të shqyrtojë një akuzë private mbi bazën e kërkesës së të dëmtuarit akuzues, ajo është kompetente të kryejë disa veprime procedurale me qëllim dhënien e drejtësisë. Këto veprime konsistojnë në pranimin për të marrë në shqyrtim kërkesën e të dëmtuarit akuzues, vlerësimin e provave të paraqitura nga i dëmtuari ose urdhërimin e organeve kompetente për të mbledhur dhe paraqitur prova, të cilat mund të jenë të rëndësishme për vërtetimin e akuzës, thirrjen e dëshmitarëve të tjerë sipas vlerësimit të vetë gjykatës. Në vijim të kësaj, mund të themi se në gjykimin e kërkesës së të dëmtuarit akuzues nuk ka ndjekje penale dhe as hetime paraprake, siç ndodh në rastin e akuzës publike. Në rastet e parashikuara nga neni 59/1 i Kodit të Procedurës Penale ka vetëm hetim gjyqësor, i cili shërben për të vërtetuar bazueshmërinë e kërkesës së të dëmtuarit dhe jo të akuzës publike të ngritur nga organi i prokurorisë. Të dëmtuarit i krijohet mundësia që edhe pa pjesëmarrjen e prokurorit të arrijë të përballet para gjykatës me autorin e veprës penale nga e cila atij i ka ardhur dëmi.

Nisur nga sa më lart, Gjykata Kushtetuese vlerëson se si akuza publike ashtu edhe akuza private të parashikuara nga legjislacioni procedural penal janë dy mekanizma që shërbejnë për ndjekjen penale të autorit të veprës penale dhe në asnjë rast ato nuk kanë për qëllim eliminimin e njëra-tjetrës. Ato bashkëveprojnë dhe në raste të caktuara gjejnë zbatim veçmas. Gjykata Kushtetuese rithekson se në asnjë rast akuza publike nuk mund të shmanget. Ajo ushtrohet sa herë që prokuroria krijon bindjen se vepra e kryer cenon rendin publik apo interesin e shoqërisë. Këtë prokuroria e bën edhe duke ndërhyrë në procesin e iniciuar nga i dëmtuari akuzues (neni 59/2 i Kodit të Procedurës Penale).

Një ndryshim tjetër midis procesit të filluar mbi një akuzë publike dhe atij të bazuar mbi akuzën private, pra nga i dëmtuari akuzues, është se ky i fundit mund të përfundojë edhe me marrëveshje kur i dëmtuari pranon të marrë një dëmshpërblim moral ose material nga i pandehuri duke tërhequr kështu akuzën në çdo fazë të procesit. Madje neni 338 i Kodit të Procedurës Penale parashikon edhe një procedurë pajtimi midis palëve në rastet e veprave penale që ndiqen me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, e cila është e detyrueshme. Nëse kjo përpjekje dështon, atëherë mund të ngrihet akuza private. Kjo bëhet me qëllim që gjykata të mos ngarkohet me shqyrtimin e çështjeve të cilat nuk mbartin në vetvete ndonjë rrezikshmëri të lartë dhe palët mund t'i kursejnë vetes një proces, i cili mund të përfundojë edhe me pafajësinë e të pandehurit ose pushimin e çështjes.

Parashikimi i veprave penale për të cilat vetë i dëmtuari akuzues duhet të vlerësojë fillimin apo jo të hetimit gjyqësor konsiderohet si një zgjidhje e mirë për ta bërë të dëmtuarin më aktiv dhe më të lirë në disponimet e tij gjatë procesit penal duke e ndjekur në mënyrë të pavarur çështjen në të gjitha shkallët e gjykimit[§].

Nga sa më sipër, Gjykata Kushtetuese arrin në përfundimin se përmbajtja e nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale nuk bie ndesh me nenin 148/1 të Kushtetutës. Ato plotësojnë njëri-tjetrin në funksion të harmonizimit më të mirë të interesit publik me atë privat. Ligjvënësi ka pasur për qëllim t'i krijojë mundësi individit të çmojë në mënyrë të pavarur shkallën e cenimit të interesave të tij dhe hapat që duhet të ndërmarrë ose jo për mbrojtjen juridike penale ose civile të tyre. Megjithatë, edhe në këto raste, ligji procedural penal nuk e shmang pjesëmarrjen e prokurorit në gjykimin e këtyre çështjeve. Prokurori jo

---

[*] *Islami/Hoxha/Panda*, Kodi i Procedurës Penale – Komentar, (2003) fq. 140.

[†] Vendim V-39/00, Përmbledhje e vendimeve të GjK (2000-2001) fq. 98.

[‡] Kjo dispozitë është shtuar me nenin 3 të ligjit nr.8813, datë 13.6.2002. E drejta për të ushtruar akuzë private, (*Privatklage – private complaint*)siç quhet ndryshe, është e parashikuar në Kodin e Procedurës Penale gjermane që në vitin 1877.

[§] Po aty, fq. 141.

vetëm merr pjesë në gjykimin e të pandehurit, por sipas rastit, kërkon dënimin ose pafajësinë e tij[*].

Gjithashtu, Gjykata Kushtetuese e gjen të pabazuar argumentin e paraqitur nga kërkuesi se mungesa e dispozitave konkrete procedurale që parashikojnë me hollësi kryerjen e veprimeve procedurale nga i dëmtuari për të vërtetuar akuzën e tij është shkak për antikushtetutshmëri. Parashikimi i veprimeve konkrete procedurale është kusht për një mbarëvajtje të procesit gjyqësor, por e kundërta e saj, pra mosparashikimi, nuk passjell detyrimisht antikushtetutshmëri. Për këtë çështje, Gjykata Kushtetuese ka tashmë një praktikë të pasur, ku në mënyrë të përsëritur theksohet se është kompetencë e ligjvënësit plotësimi ose ndryshimi i dispozitave ligjore[†].

Si përfundim, në vijim të arsyetimit të mësipërm, Gjykata Kushtetuese konstaton se përmbajtja e dispozitës së nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale, e cila i krijon mundësinë të dëmtuarit akuzues të fillojë procedimin penal për vepra penale të përcaktuara shprehimisht në të, nuk sjell ndërhyrje në kompetencat e organit të prokurorisë. Gjykata Kushtetuese çmon se dispozita e paragrafit 1 të nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale është në përputhje me nenin 148/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 145/2 të Kushtetutës dhe të nenit 68 të ligjit nr.8577, datë 10.2.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Kryetar: V. Kristo
Anëtarë: F. Abdiu, Gj. Sauli, P. Plloçi, K. Peçi, K. Puto, Xh. Zaganjori, S. Berberi, S. Sadushi

[*] Neni 59/2 I Kodit të Procedurës Penale.

[†] Vendim i Gjykatës Kushtetuese V-12/04.